



Universiteti Publik i Prizrenit “Ukshin Hoti”

Fakulteti Ekonomik

Programi – Administrim Biznesi

PROGRAMI MËSIMOR - SYLLABUS							
Niveli i studimeve	Bachelor	Programi	AB	Viti akademik	2019/20		
Lënda	Mikroekonomia						
Viti	I	Statusi i lëndës	E obliguar	Kodi		ECTS kredi	5
Semestri	I						
Javët mësimore	15		Orët mësimore 60			Ligjërata	Ushtrime
						2	2
Metodologjia e mësimit	Ligjërata, ushtrime, raste studimi, konsultime, teste, detyra						
Konsultime							
Mësimdhënësi	Prof.ass.Dr.Florije Govori			e-mail	florije.govori@uni-prizren.com		
				Tel.			

Përmbajtja e lëndës dhe qëllimi studimor	Përfitimet e studentit
<p>Në këtë lëndë trajtohen çështje që lidhen me sjelljen e agjentëve ekonomik në shoqëri dhe marrjen e vendimeve në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve ekonomike. Lënda përfshinë: analizën e tregut përmes lakoreve të ofertës dhe kërkesës, sjelljen konsumatore, zgjedhjen racionale dhe preferencat e konsumatorëve, teorinë e çmimeve në nivel të firmës dhe tregut, principet e analizës kosto-përfitim në vendimmarrje.</p> <p>Qëllimi i këtij kursi është që tu mësojë studentëve konceptet bazë të mikroekonomisë, teorinë mbi strukturën e tregut dhe formimin e çmimeve, teorinë mbi sjelljen konsumatore dhe zgjedhjen racionale, fitimet dhe kostot, efektin e një tatimi në vendimet mbi blerjen dhe shitjen e mallrave dhe shërbimeve. Kursi u mundëson studentëve të zhvillojnë intuitë ekonomike dhe aftësi në përdorimin e instrumenteve teknike për analiza të hollësishme të problemeve reale.</p>	<p>Pas përfundimit të kursit, studentët do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> të përkufizojnë ekonominë e tregut dhe mekanizmin e funksionimit të tij; të shpjegojnë ligjin e ofertës dhe kërkesës; të identifikojnë faktorët që ndikojnë në ofertë dhe kërkesë; të shpjegojnë sjelljen e konsumatorit, zgjedhjen racionale dhe preferencat e tij; të shpjegojnë teorinë mbi firmën, funksionin e prodhimit, produktin marxhinal, mesatar dhe total; të shtjellojnë strukturën e tregut-konkurrencën e plotë, monopolin, konkurrencën monopolistike dhe oligopolin duke përfshirë maksimizimin e fitimit, ekuilibrin në afat të shkurtër dhe përshtatjet në afat të gjatë; të shqyrtojnë dhe interpretojnë koston e prodhimit; të shtjellojnë fitimin ekonomik dhe fitimin

	kontabël; <ul style="list-style-type: none"> të ndërtojnë dhe interpretojnë diagramet ekonomike
--	---

Metodologjia për realizimin e temave mësimore:			
Ligjërata, ushtrime, qasje interaktive, konsultime, punime seminarike .			
Kushtet për realizimin e temës mësimore:			
Salla e pajisur me kompjuter dhe projektor			
Mënyra e vlerësimit të studentit (në%)			
<ul style="list-style-type: none"> · Angazhimi 0-10% · Puna individuale dhe grupore në detyra dhe raste studimi 0- 10 % · Testi intermediar 0-20 % · Provimi përfundimtar 0- 60 % 	Vlerësimi në %		Nota përfundimtare
	91-100		10 (dhjetë)
	81-90		9 (nëntë)
	71-80		8 (tetë)
	61-70		7 (shtatë)
	51-60		6 (gjashtë)
	0-50		5 (pesë)
Obligimet e studentit:			
Ligjërata		Ushtrime	
<ul style="list-style-type: none"> • Vijimi i ligjëratave • Pjesëmarrja aktive në diskutime gjatë ligjëratave • Pjesëmarrja në teste • Provimi përfundimtar 		<ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrja në ushtrime • Puna individuale/grupore në raste studimi dhe detyra • Pjesëmarrja në diskutime lidhur me rastet e studimit 	
Ngarkesa e studentit për lëndën			
Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej:
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime	2	15	30
Kontakte me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	4	5	20
Vërejtje: 1 ECTS kredi =25 orë angazhim.		Ngarkesa totale:	125

Java	Ligjërata	Ushtrime	
1.	<p>Tema</p> <p>Koncepte hyrëse</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shkenca mbi ekonominë • Dy fushat e ekonomiksit • Ekonomia e tregut • Kufiri i mundësive të prodhimit • Metodologjia e shkencës ekonomike <p>Literatura:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ahmet Maçellari, Sulo Haderi, Dhori Kule, Stefan Qirici: Hyrje ne ekonomi, Pegi, Tiranë, 2007 2. Robert H. Frank: Microeconomics and Behavior, McGraw-Hill, Inc 2014 	2	<p>Tema</p> <p>Orët</p> <p>2</p>
2.	<p>Analiza e kërkesës dhe ofertës</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kërkesa dhe lakorja e kërkesës • Ndryshimi i kërkesës dhe ndryshimi i sasisë së kërkuar • Oferta dhe lakorja e ofertës • Ndryshimi i ofertës dhe ndryshimi i sasisë së ofruar • Faktorët që përcaktojnë kërkesën dhe ofertën. <p>Literatura:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ahmet Maçellari, Sulo Haderi, Dhori Kule, Stefan Qirici: Hyrje ne ekonomi, Pegi, Tiranë, 2007 2. Robert H. Frank: Microeconomics and Behavior, McGraw-Hill, Inc 2014 3. HalR. Varian: "Mikroekonomia", Onufri , Tiranë, 2000 	2	2

3.	<p>Funksionet e çmimeve dhe efekti i tatimit mbi ofertën dhe kërkesën</p> <ul style="list-style-type: none"> • Funksioni i çmimeve në ekonomitë e tregut • Mbështetja e çmimeve • Efekti i tatimit në ofertë dhe kërkesë <p>Literatura:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Robert H. Frank: Microeconomics and Behavior, McGraw-Hill, Inc 2014 2. HalR. Varian: “Mikroekonomia”, Onufri , Tiranë, 2000 	2		2
4.	<p>Elasticiteti i ofertës dhe kërkesës</p> <ul style="list-style-type: none"> • Elasticiteti i kërkesës lidhur me çmimin • Elasticiteti i kërkesës lidhur me të ardhurën • Elasticiteti i tërthortë i kërkesës • Elasticiteti i ofertës lidhur me çmimin • Faktorët që përcaktojnë elasticitetin e ofertës dhe kërkesës <p>Literatura:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ahmet Maçellari, Sulo Haderi, Dhori Kule, Stefan Qirici: Hyrje ne ekonomi, Pegi, Tiranë, 2007 2. Robert H. Frank: Microeconomics and Behavior, McGraw-Hill, Inc 2014 	2		2
5.	<p>Sjellja konsumatore</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zgjedhja racionale • Dobia margjinale (Cobb-Douglas) • Analiza ordinaliste e zgjedhjes konsumatore <p>Literatura:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ahmet Maçellari, Sulo Haderi, Dhori Kule, Stefan Qirici: Hyrje ne ekonomi, Pegi, Tiranë, 2007 2. Robert H. Frank: Microeconomics and Behavior, McGraw-Hill, Inc 2014 3. HalR. Varian: “Mikroekonomia”, Onufri, Tiranë, 2000 	2		2

6.	<p>Teoria e firmave</p> <ul style="list-style-type: none"> • Firmat dhe objektivat e firmave • Llojet e firmave • Rritja e kapitalit • Pasqyrat financiare <p>Literatura:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ahmet Maçellari, Sulo Haderi, Dhori Kule, Stefan Qirici: Hyrje ne ekonomi, Pegi, Tiranë, 2007 2. Robert H. Frank: Microeconomics and Behavior, McGraw-Hill, Inc 2014 	2		2
7.	<p>Funksioni i prodhimit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Funksioni i prodhimit në periudha afatshkurtëra • Ligji i të ardhurave zbritëse • Të ardhurat e shkallës, faktori kohë dhe ndryshimet teknologjike • Funksioni i prodhimit në periudha afatgjata <p>Literatura:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ahmet Maçellari, Sulo Haderi, Dhori Kule, Stefan Qirici: Hyrje ne ekonomi, Pegi, Tiranë, 2007 2. Robert H. Frank: Microeconomics and Behavior, McGraw-Hill, Inc 2014 3. HalR. Varian: “Mikroekonomia”, Onufri, Tiranë, 2000 	2		2
8.	<p>Kostoja</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kosto oportune • Kosto në periudha afatshkurtëra • Kosto në periudha afatgjata <p>Literatura:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ahmet Maçellari, Sulo Haderi, Dhori Kule, Stefan Qirici: Hyrje ne ekonomi, Pegi, Tiranë, 2007 2. Robert H. Frank: Microeconomics and Behavior, McGraw-Hill, Inc 2014 3. HalR. Varian: “Mikroekonomia”, Onufri, Tiranë, 2000 	2		2

9.	<p>Struktura e tregut – Konkurrenca e plotë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tiparet • Lakorja e kërkesës e firmës dhe oferta e firmës në afate të shkurtëra • Vendimet dhe sjellja e firmës • Konkurrenca e plotë dhe eficiency ekonomike <p>Literatura:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ahmet Maçellari, Sulo Haderi, Dhori Kule, Stefan Qirici: Hyrje ne ekonomi, Pegi, Tiranë, 2007 2. Robert H. Frank: Microeconomics and Behavior, McGraw-Hill, Inc 2014 3. HalR. Varian: “Mikroekonomia”, Onufri, Tiranë, 2000 	2		2
10.	<p>Monopoli</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tiparet • Lakorja e kërkesës dhe maksimizimi i fitimit në monopol • Eficiency në kushtet e monopolit • Diskriminimi i çmimeve dhe politikat shtetërore për kontrollin e monopolit <p>Literatura:</p> <ol style="list-style-type: none"> 4. Ahmet Maçellari, Sulo Haderi, Dhori Kule, Stefan Qirici: Hyrje ne ekonomi, Pegi, Tiranë, 2007 5. Robert H. Frank: Microeconomics and Behavior, McGraw-Hill, Inc 2014 6. HalR. Varian: Mikroekonomia, Onufri, Tiranë, 2000 1. 	2		2
11.	<p>Konkurrenca monopoliste</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tiparet • Maksimizimi i fitimit për firmën në konkurrencën monopolistike <p>Literatura:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ahmet Maçellari, Sulo Haderi, Dhori Kule, Stefan Qirici: Hyrje ne ekonomi, Pegi, Tiranë, 2007 2. Robert H. Frank: Microeconomics and 	2		2

	<p>Behavior, McGraw-Hill, Inc 2014</p> <p>3. HalR. Varian: “Mikroekonomia”, Onufri, Tiranë, 2000</p>			
12.	<p>Oligopoli</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tiparet • Llojet e oligopolit • Modele të oligopolit <p>Literatura:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ahmet Maçellari, Sulo Haderi, Dhori Kule, Stefan Qirici: Hyrje ne ekonomi, Pegi, Tiranë, 2007 2. Robert H. Frank: Microeconomics and Behavior, McGraw-Hill, Inc 2014 3. HalR. Varian: “Mikroekonomia”, Onufri, Tiranë, 2000 	2		2
13.	<p>Faktorët e tregut – Puna, toka dhe kapitali</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpërndarja e të ardhurave • Paga si çmim i faktorit punë • Renta si çmim i faktorit tokë • Interesi si çmim i faktorit kapital <p>Literatura:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ahmet Maçellari, Sulo Haderi, Dhori Kule, Stefan Qirici: Hyrje ne ekonomi, Pegi, Tiranë, 2007 2. Robert H. Frank: Microeconomics and Behavior, McGraw-Hill, Inc 2014 3. HalR. Varian: “Mikroekonomia”, Onufri, Tiranë, 2000 	2		2
14.	<p>Ekulibri i përgjithshëm dhe mirëqenia</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndërhyrja e shtetit në ekonomi • Alokimi optimal i burimeve • Sigurimi i drejtësisë në shpërndarje • Përdorimi i plotë i burimeve dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve 	2		2

	<p>Literatura:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ahmet Maçellari, Sulo Haderi, Dhori Kule, Stefan Qirici: Hyrje ne ekonomi, Pegi, Tiranë, 2007 2. Robert H. Frank: Microeconomics and Behavior, McGraw-Hill, Inc 2014 3. Hal R. Varian: "Mikroekonomia", Onufri, Tiranë, 2000 			
15.	<p>Eksternalitetet dhe sektori publik</p> <ul style="list-style-type: none"> • Eksternalitetet pozitive • Eksternalitetet negative 	2		2
	<p>Literatura:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ahmet Maçellari, Sulo Haderi, Dhori Kule, Stefan Qirici: Hyrje ne ekonomi, Pegi, Tiranë, 2007 2. Robert H. Frank: Microeconomics and Behavior, McGraw-Hill, Inc 2014 3. Hal R. Varian: "Mikroekonomia", Onufri, Tiranë, 2000 			

LITERATURA
<p>Bazë</p> <p>Ahmet Maçellari, Sulo Haderi, Dhori Kule, Stefan Qirici: Hyrje ne ekonomi, Pegi, Tiranë, 2007</p> <p>Plotësuese</p> <p>Hal R. Varian: "Mikroekonomia", Onufri, Tiranë, 2000</p> <p>Robert H. Frank: Microeconomics and Behavior, McGraw-Hill, Inc 2014</p>
VËREJTJE
<p>Në fund të çdo ore mësimore, studentët do të angazhohen me detyrë apo studim rasti lidhur me temën e ligjëruar. Rezultatet e arritura studentët duhet t'i prezantojnë dhe t'i diskutojnë në orën e ushtrimeve.</p>

Vërejtje për studentin:

- Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore
- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit në teste dhe provim
- Gjatë hartimit të punimeve, studenti duhet t'i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimmhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.